



Agjencia e Akreditimit e Kosovës
Kosovo Accreditation Agency
Agencija za Akreditovanje Kosova

Qendra e Studentëve, kati i II-të
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel : +381 38 213-722
Fax:: +381 38 213-990
e-mail: kaaoffice@gmail.com
web: www.akreditimi-ks.org

Nr. 402/10 dt. 09. 06. 2009

Për: Z. Bajram Uka, Dekan i Fakultetit Juridik-Universiteti i Prishtinës

NJOFTIM

Mbështetur në LAL 2/2003 dhe Udhëzimet administrative që dalin nga ky ligj: UA 11/2004 për Themelimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës, UA 1/2009 për Akreditimin e Institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë, dëshiroj t'ju njoftoj se Këshilli Kombëtar i Cilësisë i Agjencisë së Akreditimit të Kosovës, ka shqyrtuar aplikacionin tuaj për akreditim dhe në mbledhjen e vet të mbajtur më 15.05.2010 ka vendosur si në vijim:

Programet e akredituara

I. Akreditohet për periudhë dy vjeçare programi Baqelor në Drejtësi **me kusht që:**

1. Fakulteti Juridik të zhvilloj dhe përvetësoj një Plan zhvillimi të personelit akademik me qëllim të ngritjes së numrit të antarëve të personelit akademik me orar të plotë dhe të dorëzoj këtë plan mbas tre muajsh, pas vendimit përkatës të AAK-së, para organeve të universitetit që janë kompetentë për vendime, dhe
2. Një vit pas vendimit përkatës të AAK-së, të dëshmohet se numri i anëtarëve të stafit akademik të punësuar me orar të plotë në raport me numrin e studentëve të jetë përmirësuar në krahasim me raportin që ka ekzistuar në fund të vitit 2009.

Ky Plan duhet të përfshijë çështjet në vijim:

- a. Një qëllim konkret (p.sh. numër i caktuar i personelit akademik ne kategori të ndryshme me qëllim të rritjes së raportit ndërmjet numrit të personelit akademik dhe numrit të studentëve) që duhet të arrihet
- b. Një afat kohor të kufizuar ,
- c. Mjetet dhe hapat konkretë që janë të nevojshëm për arritjen e qëllimeve, dhe
- d. Resurset, posaqërisht resurset financiare, që janë të nevojshme për arritjen e qëllimit.

II. Akreditohet programi 2 vjeçar Master në Drejtësi

Prishtinë, 07.06.2010

Me respekt,
Dr. Ferdije Zhushi Etemi, kryetare
Këshilli Kombëtar i Cilësisë
Agjencia e Akreditimit e Kosovës

